REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 76/22
Datë/Datum. 29.03.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

Nr.76/ 22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër te protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE "EVERLIGHT Consulting" me seli në Prishtinë , te parashtruara për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objekteve ushtarake e ndarë në katër pjesë, projekt një vjeçarë Pjesa 1 Ndërtimi i pikës së karburantit(Kazerma Istog) Pjesa 2 Ndriçimi në Kazermat e FSK-së Kazerma Prishtinë) Pjesa 3 Ndërtimi i pishinës-(Kazerma Pomozotin) Pjesa 4 Ndërtimi i poligonit për kërkim-shpëtim-(Kazerma Pomozotin), ku ankesa është parashtruar vetëm për **lot 2** " me nr prokurimi "217-22-1373-5-2-1" iniciuar nga AK- "Ministria e Mbrojtjes, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 29 MARS 2022 mori ketë:

VENDIM

I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE "EVERLIGHT Consulting" me seli në Prishtinë , te parashtruara për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objekteve ushtarake e ndarë në katër pjesë, projekt një vjeçarë Pjesa 1 Ndërtimi i

pikës së karburantit(Kazerma Istog) Pjesa 2 Ndriçimi në Kazermat e FSK-së Kazerma Prishtinë) Pjesa 3 Ndërtimi i pishinës-(Kazerma Pomozotin) Pjesa 4 Ndërtimi i poligonit për kërkim-shpëtim - (Kazerma Pomozotin), ku ankesa është parashtruar vetëm për **lot 2** " me numër prokurimi "217-22-1373-5-2-1" iniciuar nga AK- "Ministria e Mbrojtjes.

II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Ministria e Mbrojtjes që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i objekteve ushtarake e ndarë në katër pjesë, projekt një vjeçarë Pjesa 1 Ndërtimi i pikës së karburantit(Kazerma Istog) Pjesa 2 Ndriçimi në Kazermat e FSK-së Kazerma Prishtinë) Pjesa 3 Ndërtimi i pishinës-(Kazerma Pomozotin) Pjesa 4 Ndërtimi i poligonit për kërkim-shpëtim-(Kazerma Pomozotin), ku ankesa është parashtruar vetëm për **lot 2** " me numër prokurimi "217-22-1373-5-2-1" iniciuar nga AK- "Ministria e Mbrojtjes, (përkitazi me ketë ankesë dhe për Lotin që është parashtruar ankesa , nëse nuk ka ankesë tjetër).

III. Ankesat e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, ju kthehet tarifa e ankesës.

IV. **Obligohet ,** OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Më datën 28.03.2022 Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE "EVERLIGHT Consulting" me seli në Prishtinë , te parashtruara për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objekteve ushtarake e ndarë në katër pjesë, projekt një vjeçarë Pjesa 1 Ndërtimi i pikës së karburantit(Kazerma Istog) Pjesa 2 Ndriçimi në Kazermat e FSK-së Kazerma Prishtinë) Pjesa 3 Ndërtimi i pishinës-(Kazerma Pomozotin) Pjesa 4 Ndërtimi i poligonit për kërkim-shpëtim-(Kazerma Pomozotin), ku ankesa është parashtruar vetëm për **lot 2** " me numër te prokurimi "217-22-1373-5-2-1" iniciuar nga AK- "Ministria e Mbrojtjes.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE "EVERLIGHT Consulting" me seli në Prishtinë , me numër të protokollit 76/2022, te datës 28.03.2022, ankese kjo e parashtruara për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objekteve ushtarake e ndarë në katër pjesë, projekt një vjeçarë Pjesa 1 Ndërtimi i pikës së karburantit(Kazerma Istog) Pjesa 2 Ndriçimi në Kazermat e FSK-së Kazerma Prishtinë) Pjesa 3 Ndërtimi i pishinës-(Kazerma Pomozotin) Pjesa 4 Ndërtimi i poligonit për kërkim-shpëtim-(Kazerma Pomozotin), ku ankesa është parashtruar vetëm për **lot 2** " me numër prokurimi "217-22-1373-5-2-1" iniciuar nga AK- "Ministria e Mbrojtjes dhe bazuar në verifikimin e shkresave të lëndës si dhe sqarimeve të dhëna nga palët në procedure dhe sqarimet e dhëna nga zyrtaret përgjegjës të OSHP-së, që kanë verifikuar në platformën e-prokurimit rezulton se kjo ankesë hedhet si të pa lejuara sepse:

Lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objekteve ushtarake e ndarë në katër pjesë, projekt një vjeçarë Pjesa 1 Ndërtimi i pikës së karburantit(Kazerma Istog) Pjesa 2 Ndriçimi në Kazermat e FSK-së Kazerma Prishtinë) Pjesa 3 Ndërtimi i pishinës-(Kazerma Pomozotin) Pjesa 4 Ndërtimi i poligonit për kërkim-shpëtim-(Kazerma Pomozotin), ku ankesa është parashtruar vetëm për **lot 2** " me numër prokurimi "217-22-1373-5-2-1" iniciuar nga AK- "Ministria e Mbrojtjes, Autoriteti kontraktues Ministria e Mbrojtjes ka ngarkuar Njoftimin për Kontrate me datë:04.03.2022. Hapja e ofertave është bere me datë: 28.03.2022 .
Nga OE ankues nuk është proceduar kërkesa për rishqyrtim, te cilën gjë e dëshmon vet ankuesi në shkresën e dt.28.03.2022 dërguar OSHP-së.

Gjithashtu është verifikuar që në procesverbal të hapjes OE " EVER LIGHT Consulting" me seli në Prishtinë nuk është pjesëmarrës i aktivitetit të prokurimit në fjalë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se operatori ekonomik "EVER LIGHT Consulting" me seli në Prishtinë pretendimet e tija ankimore i ka kundër njoftimit për kontrate , pra ankesa është për disa kritere te dosjes së tenderit, ku ankuesi kërkon që të anulohet procesi i hapjes së tenderëve dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë te Ri tenderohet duke i ndryshuar kushtet kriteret e dosjes së tenderit.

Duke pas parasysh faktin se OE ankues nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim fare në AK por ka vazhduar me ankesë në OSHP konstatojmë se ankesa e "EVER LIGHT Consulting" me seli në Prishtinë , me numër te protokollit 76/2022, te datës 28.03.2022, ankese kjo e parashtruara për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i objekteve ushtarake e ndarë në katër pjesë, projekt një vjeçarë Pjesa 1 Ndërtimi i pikës së karburantit(Kazerma Istog) Pjesa 2 Ndriçimi në Kazermat e FSK-së Kazerma Prishtinë) Pjesa 3 Ndërtimi i pishinës-(Kazerma Pomozotin) Pjesa 4 Ndërtimi i poligonit për kërkim-shpëtim-(Kazerma Pomozotin), ku ankesa është parashtruar vetëm për **lot 2** " me numër prokurimi "217-22-1373-5-2-1" hedhet si i pa lejuar sepse kjo ankese është parashtruar në kundërshtim me nenin 108/A dhe nenin 109 të LPP-së.

Sepse neni 109 specifikon:

Afatet për Dorëzimin e Ankesës

Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se ankesa e OE ankues "EVERLIGHT Consulting" me seli në Prishtinë me numër të protokollit 76/2022 e datës: 28.03.2022, hedhet si e pa lejuar

sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP pa udhëhequr fare një procedurë paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes, në shkallen e parë pran autoritetit kontraktues, pra ankesa në OSHP është dorëzuar pa pasur një kërkesë për rishqyrtim fillimisht në autoritetin kontraktues ministria e mbrojtjes, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi, Sekretariatit të OSHP-së

Ardian BEHRA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Ministria e Mbrojtjes

1x1 OE "EVERLIGHT Consulting" me seli në Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së